

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Departamenti i Përfaqësimeve Gjyqësore, kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR] p.n., për shkak të pasurimit pabazë, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 15.03.2018, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi, padia dhe kërkesëpadija e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, e ushtruar kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për shkak të pasurimit pabazë në shumë prej 880.00 €, si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Gjykata me datë 25.01.2016 ka pranuar padinë e paditëses kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për shkak të pasurimit pa bazë, në kontestin në vlerë prej 880.00 €.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe përkesëpadisë dhe konsiderojmë se Gjykata ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë se i padituri e ka tërhequr shumën në vlerë prej 880.00 €, prandaj edhe i propozoj Gjykatës që padinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Mëtej paditësja lidhur me pretendimet e të paditurit se biznesi i regjistruar në emër të tij D.P.T. [REDAKTUAR] nuk ka qenë aktiv, deklaron se provat e paraqitura nga i padituri përfshijnë periudhën gjatë vitit 2005, ndërsa të paditurit i është miratuar pensioni invalidor nga data 09.11.2004.

I padituri në gjatë senacave dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sepse ne e kemi pasur biznesin e regjistruar, mirëpo, biznesi që nga regjistrimi e deri më tani nuk ka funksionuar asnjëherë dhe nuk kemi krijuar asnjëherë fitim nga ky biznes. Mëtej, i padituri shton se nga provat e paraqitura pranë kësaj gjykate, e sidomos nga reportet financiare – pasqyrat tremujore të dorëzuara në ATK shihet se ne nuk kemi zhvilluar veprimtari biznesi dhe as nuk kemi krijuar asnjë fitim gjatë periudhës së marrjes së pensionit invalidor, andaj, nga të themsuarat më lartë, i padituri i propozon Gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: *raportet-pasqyrat tremujore TM1/2005 i dt. 14.04.2005, TM2/2005 i dt.14.07.2005, TM3/2005 i dt.13.10.2005, TM4/2005 i dt.05.01.2006; raporti specialistik i dt.09.05.2017; ankesa e Zyres regjionale të AKP Ferizaj me nr. protokollit: 154 i dt.04.05.2006; lista nga Qendra Informativë e llogarisë rrjedhëse nr. [REDAKTUAR] në emër të [REDAKTUAR]*

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga administrimi dhe shqyrtimi i provave, ka konstatuar këtë gjendje faktike: ekziston fakti se i padituri ka pranuar mjetet financiare nga paditësja në shumë prej 880.00 €, në llogarinë e tij rrjedhëse, të cilat mjete paditësja përmes Komisionit të saj profesional mjekësor i'a ka miratur të paditurit në emër të pensionit invalidor. Poshtu u konstatua se i padituri në vitin 2005 e ka regjistruar biznesin në emër të tij me emrin D.P.T. [REDAKTUAR], mirëpo nga të njetat prova, e sidomos nga deklaratat-pasqyrat financiare të ATK-së, TM1/2005, TM2/2005, TM3/2005 dhe TM4/2005 i dt.01.03.2006 në emër të biznesit D.P.T. [REDAKTUAR] me pronar [REDAKTUAR], Gjykata ka konstatuar se gjatë kohës së tërheqjes së pensionit invalidor nga i padituri, i njejtë biznes nuk ka qenë aktiv dhe nuk ka krijuar asnjë të ardhur financiare për të paditurin [REDAKTUAR].

Gjykata nga arsyet e lartëcekura, ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë, sepse në këtë rast nuk janë plotësuar elementet e ekzistimit të pasurimit të pabazë.

Andaj nga arsyet e lartëcekura, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 319 dhe 322 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së, me që asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e krijuara me fajin e palës tjetër.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.58/16, me datë 15.03.2018

Gjyqtari,
Misin Frangu



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
REPUBLIKA E PRAVNOŠNAŽIKA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / ЖУРОШЕВАЦ

Me
Data 14 03 2018

